Historia e Lindjes Lashte

UNIVERSITETI I SHKODRËS
"LUIGJ GURAKUQI"
Fakulteti i Shkencave Shoqërore
Departamenti i Historisë

PROGRAM I LËNDËS
" HISTORIA E VENDEVE TË LINDJES SË LASHTË"
PËR DEGEN HISTORI

Numri i kodit: 0203
Kredite: 4
Titullari: Pr.As.Dr.Paulina Hoxha
Koha e realizimit: Viti i parë, Semestri i parë
Kontaktimi i Pedogogut : Universiteti i Shkodrës "L.Gurakuqi"
Departamenti i Historisë, Shkodër, e-mail: ina.hoxha@yahoo.com

Përmbledhje për lëndën

Lënda "Histori e Vendeve të Lindjes së Lashtë" zhvillohet me studentët e kursit të parë të degës Histori si dhe me studentët me kohë të pjesshme.
Kjo lëndë përmban 3 kapituj dhe 12 tema për historinë e qytetërimeve të para si ai egjiptian , babilonas, persian indian, fenikas, hebre etj. Temat janë të ndara në çështje e nënçështje në të cilat në mënyrë kronologjike jepen njohuritë që nga parahistoria e shoqërisë njerëzore me të gjitha epokat, paleolit, mezolit, neolit e të metaleve, si dhe formimin e zhvillimin e qytetërimeve të mëdha me të gjitha karakteristikat e veçoritë e tyre.
Në këtë kurs leksionesh jepet një kuadër i plotë i zhvillimit ekonomik, shoqëror, politik e kulturor të këtyre popujve.

Objektivat:

Objektiva të përgjithshme.

Në përfundim të këtij kursi, studentët duhet që :
1.Të kenë njohuri të plota e shkencore për zhvillimin historik të shoqërisë njerëzore.
2.Të njohin e të zotërojnë etapat që ka kaluar procesi i këtij zhvillimi.
3.Të jenë plotësisht të aftë të bëjnë analiza shkencore për ngjarjet e shkuara historike.
4.Të zhvillojnë sensin e ndërgjegjes historike e të përgatiten si pjestarë aktivë të shoqërisë demokratike.

Objektivat e përbashkëta:
-Të përvetësojnë nga pikpamja kronologjike e terminologjike, ngjarjet e dukuritë e historisë së popujve të Lindjes së Lashtë.
-Të dijnë të vlerësojnë e të analizojnë ngjarjet kryesore të cilat kanë sjellë ndryshime të rëndësishme në zhvillimin ekonomik, shoqëror, politik e kulturor të një vendi apo të mbarë shoqërisë njerëzore.
-Të kuptojnë e të vlerësojnë lidhjet reciproke ndërmjet vendeve, bashkëpunimin e kundërshtitë, përfitimet reciproke ndërmjet qytetërimeve të ndryshme.

Veprimtaritë (orët teorike 22.5 orë , seminare 7.5 orë)
Ngarkesa mësimore do të jetë 1.5x0,5 në semestrin e parë në vitin e parë, nga të cilat 22.5 orë kurse teorike që realizohen nëpërmjet leksioneve të cilat trajtojnë problematikën kryesore në lidhje me historinë e qytetërimeve të Lindjes së Lashtë.
Në orët e seminareve(7.5 orë) do të realizohen në trajtën e diskutimeve, analizave dhe krahasimeve ngjarjet e ndryshme historike, epokat, literatura etj.

Studentët do të hartojnë edhe 5 esse.

Politikat e frekuentimit

Frekuentimi i orëve mësimore teorike (leksioneve) është fakultativ. Ndërsa frekuentimi i seminareve është deri në masën 75% bazuar në rregulloren ekzistuese të studimeve.

Politikat e Vlerësimit të studentëve.

Lënda është provim.
Provimi vlerësohet me 70 pikë.
Vlerësimi gjatë semestrit do të jetë me 30 pikë nga ku:
- Ndjekja e leksioneve: 5 pikë
- Shlyerja e seminareve: 10 pikë
- Esetë: 5 pikë
- Dy teste gjatë semestrit 10 pikë

Vlerësimi përfundimtar i studentit për këtë lëndë do të bazohet në shumën e pikëve të fituara gjatë semestrit nga 0-30 pikë dhe gjatë zhvillimit të procesit të provimit nga 0-70 pikë.
Pikët e fituara sëbashku konvertohen në notë ku :
Nga 45-54 pikë të grumbulluara vlerësohen me notën 5 (pesë)
Nga 55-64 pikë të grumbulluara vlerësohen me notën 6 (gjashtë)
E kështu me radhë

PROGRAMI I LËNDËS
HISTORIA E VENDEVE TË LINDJES SË LASHTË

I.Origjina dhe parahistoria e njeriut

- Historia dhe Parahistoria. Bazat shkencore për njohjen e parahistorisë. Teoria e evolucionit dhe seleksionit nat ominidëve (paraardhësve) e deri tek njeriu.
- Epoka e Paleolitit, Epoka Mezolitit, Epoka Neolitit, Epoka Kalkolitit.
- Revolucioni metalurgjik. Lindja e qyteteve.Konkluzione

II.Vëndet e Lindjes së Lashtë.

1- Qytetërimet e para të lumenjve.
Burimet historike për studimin e këtyre qytetërimeve.

2-Qytetërimi i vjetër Egjiptian

-Justifikimi i një zgjedhjeje.
-Kushtet natyrore në luginën e Nilit. Popullsia më e vjetër dhe zhvillimi i saj në mijëvjecarin e V-IV p.K. Pushteti
-Mbretëria e Vjetër e Egjiptit (3200-2100 p.K.) Zhvillimi ekonomik, shoqëror dhe organizimi politik. Forcimi i arist së nomeve dhe rënja e Mbretërisë së Vjetër.
-Mbretëria e Mesme e Egjiptit (2100-1600p.K.) Zhvillimi i përgjithshëm i Egjiptit në këtë periudhë. Pushtimi i hyk
-Mbretëria e Re (1600-1100p.K.) Ribashkimi dhe forcimi i Egjiptit. Faraonët e dinastisë së XVIII dhe formimi i sh ushtarak egjiptian. Reforma fetare e Ehnatonit. Dinastia e XIX dhe rënia e Mbretërisë së Re.
-Mbretëria e Vonë (1100-525p.K.). Pushtimi asirian. Dinastia “saise”. Pushtimi i Egjiptit nga persët.
-Kultura në Egjiptin e Lashtë. Shkrimi dhe letërsia egjiptiane. Feja, dijet shkencore të kohës, arti e arkitektura eg

3- Qytetërimi i Mesopotamisë.

-Një tjetër qytetërim i lumenjve. Shumerët dhe Akadët. Origjina e qytetërimit shumerik. Zhvillimi ekonomik dhe s tyre. Mbretëria e Eblës.
-Mbretëria e Babilonisë. Kodi i Hamurabit dhe zhvillimi i shoqërisë babilonase. Rënia e mbretërisë babilonase.
-Kultura shumero-babilonase. Shkrimi dhe letërsia. Epi i Gilgameshit. Feja e vjetër e shumero-babilonasve. Tek shkenca. Skulptura e arkitektura.

4- Asiria e Vjetër.

-Vëndi Asiri, kushtet natyrore dhe popullsia.
-Asiria në mijëvjeçarin III-IIp.K.
-Formimi i shtetit ushtarak asirian në mijëvjeçarin I p.K.
-Asiria në shek.VIII-VIIp.K., ekonomia dhe shoqëria.
-Rënia e Asirisë.
-Kultura asiriane, feja, letërsia zyrtare, ndërtimet arkitekturore.

5- Fenikia e Vjetër.

-Pozicioni gjeografik
-Ngjarjet e përgjithshme rreth historisë politike të mbretërisë fenikase.
-Aktiviteti ekonomik, jeta shoqërore dhe organizimi politik.
-Lundërtarë të guximshëm dhe kolonizimi i Perëndimit prej tyre.
-Kultura fenikase, feja, letërsia, shkrimi alfabetik, arti etj.

6. Hebrejtë

-Vëndi dhe popullsia e vjetër.
-Fama e hebrejve. Jeta ekonomike.
-Mbretëria e Izraelit dhe e Judesë.
-Ndarja e Izraelit nga Judea.
-Fundi i mbretërive të Izraelit dhe Judesë.
-Kultura. Feja, profetët, letërsia etj.

7. Hititët (hetët).

-Zbulimet e qytetërimit hitit. Aktiviteti ekonomik, revolucioni në metalurgji. Jeta shoqërore dhe struktura politike. Legjislacioni tek hititët dhe karakteri human i tij.
-Perandoria hitite në shek. XV p.K.nën sundimin e Supiluliumas.
-Kultura, feja dhe arti tek hititët.

8-Persia e Vjetër

-Natyra dhe popullsia e vjetër.
-Mbretëria e Medëve dhe e Persëve.
-Formimi i perandorisë perse. Dari i I Hystaspi dhe organizimi i shtetit të madh persian nga ai. Rënia e mbretëris
-Kultura persiane. Feja e persianëve. Karakteristikat e Zoroastrizmit.
-Zhvillimet e tjera kulturore të persëve dhe karakteri eklektik i artit persian.

III- Qytetërimet e Lindjes së Largët

1-Qytetërimi i Vjetër Indian.

-Pozicioni gjeografik dhe kushtet natyrore. Popullsia më e vjetër në mijëvjeçarin e III-IIp.K. Dravidët dhe qytetëri
-Ardhja e Arianëve. Jeta ekonomike dhe shoqërore. Institucionet politike.
-Institucioni i Kastave në Indi.Lëvizja reformiste. Budizmi.
-Dinastia e Maurëve. Mbretëria e Çandraguptës dhe e Ashokut. Rënia e dinastisë Maure.
-Kultura e popullit të vjetër indian. Besimi i arianëve të vjetër, Vedat, brahmanizmi. Letërsia, këngët epike. Arritje kulturën e Indisë.

2- Qytetërimi i Vjetër Kinez.

-Burimet historike. Popullsia e lashtë në periudhën e neolitit.
-Dinastia Shang-Inj. Zhvillimi ekonomik, shoqëria dhe institucionet politike.

-Dinastia Czhou. Periudha klasike e Kinës. Zhvillimi ekonomik e politik i shtetit Czhou (1122-247p.K.)
-Perandori Cinj (246-207p.K.) dhe ajo e Hanj-ëve të hershëm(206p.K.-24 pas K.). Reformat e Uan Manit
-Perandoria e Hanj-ëve të vonë(25-220 pas.K.)
-Kultura në Kinën e Vjetër. Arritjet në shkencë e teknikë. Doktrina e Konfucizmit e Taoizmit.

Literatura bazë:

1.U.Sh.T, Historia e Lindjes së Lashtë. Tiranë, 1962
2.Todi Dhama, Historia e Kohës së Vjetër, Lindja e Lashtë. Tiranë, 1990.
3.F. Dittatore Vonwiller e V. Fusko, C. Giglio- P. Matthiae- E. Bresciani.
-Storia Universale dei Popoli e delle Civiltà, “Preistoria e Vicino Oriente Antico”.Vol.I, Torino, 1981.
4.Grup Autorësh, “Enciclopedia Storica”, Zanichelli, Bologna, 2000.
5.B.G.Trigger, B.J.Kemp, D.O’Connor and A.B.Lloyd, “Ancient Egypt: Asocial History”, Cambridge, 1994.
6.A.Camera. R. Fabietti, “Oriente e Grecia”. Bologna, 1996.
7.E.Mc. Burns, Ph. L.Rarph, “World Civilizations” Vol.I, New York, 1958.